



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 01/2014
Prishtinë, më 23.12.2014, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Visar Ymeri, Sasha Milosavljeviq, Sala Berisha-Shala, Besim Beqaj, Raif Qela, Blerim Grainca dhe Pal Lekaj - anëtarë.

Munguan: Fatmir Rexhepi, Fatmir Limaj dhe Duda Balje - anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Burim Ejupi dhe Dardan Abazi – INDEP; Qëndresa Mrasori - KDI; dhe Saniye Berisha- OSBE.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Konstituimi i Komisionit;
2. Diskutim lidhur me detyrat, prioritet dhe organizimin e Komisionit.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.

1. Konstituimi i Komisionit

Kryetari i Komisionit, **Muhamet Mustafa**, fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe prezantoi përbërjen e anëtarëve të Komisionit, stafin mbështetës të Komisionit dhe të pranishmit tjerë, si partnerët e jashtëm dhe të organizatave të shoqërisë civile që monitorojnë dhe mbështesin punën e komisionit funksional, si INDEP dhe KDI. Tha se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri mbulon një fushë të gjerë të çështjeve vitale që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik të vendit dhe prej të gjithëve kërkoi angazhim, në mënyrë që të arrijmë zbatimin e plotë të fushëveprimit të Komisionit.

Në fund të diskutimit, kryetari shpalli të konstituar Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për Legjislaturën V.

3. Diskutim lidhur me detyrat, prioritet dhe organizimin e Komisionit

Kryetari, tha se në këtë pikë të rendi të ditës do t'i diskutojmë orientimet e punës që do t'i kemi në këtë mandat dhe çështjet që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e Komisionit. Ai shtoi më tej se përgjegjësia dhe fushëveprimi i Komisionit përfshin: shqyrtimin e projektligjeve; mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve; shqyrtimin e strategjisë së përgjithshme për zhvillimin e veprimtarive ekonomike; mjedisin biznesor; investimet vendore dhe të huaja; rritjen ekonomike; angazhimin për përcaktimin dhe përcjelljen e zbatimit të politikave të përgjithshme në fushën e ekonomisë, të tregtisë, të industrisë, të energjetikës dhe të transportit; mbikëqyrjen e punës dhe funksionimit të agjencive të pavarura që i raportojnë Komisionit; shqyrtimin e projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të ministrive. Ai i njoftoi deputetët se Komisioni i mbikëqyrë shatë agjenci të pavarura dhe pothuajse të gjitha janë aktualisht jashtë funksionit, sepse u mungojnë bordet. Po ashtu, e njoftoi Komisionin se e kemi një buxhet që mund ta shfrytëzojmë, por do të kërkojmë ndihmë edhe nga donatorët që të na ndihmojnë me fonde dhe ekspertiza të specializuara, sepse Komisioni mbulon një fushë të gjerë. Pastaj, kërkoi nga deputetët që të paraqesin propozimet e tyre lidhur me detyrat, prioritet dhe organizimin e Komisionit.

Visar Ymeri, tha se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri është njëri ndër komisionet më të rëndësishme, sepse ka një vëllim të madh të punëve duke mbikëqyrë një fushë të gjerë në aspektin e përgjithshëm ekonomik. Sa i përket agjencive që i raportojnë Komisionit, tha se janë strukturat më të rëndësishme ekonomike, dhe në mandatin e kaluar, së bashku me organizatën INDEP që e ka mbështetur punën e Komisionit, kemi hartuar disa rekomandime për përmirësimin dhe mënyrën e funksionimit të këtyre agjencive. Ai shtoi më tej se një problematikë tjetër që duhet të merret Komisioni janë edhe ndërmarrjet publike, edhe pse ato i raportojnë Qeverisë, mirëpo ne si Komision duhet që të mbikëqyrim edhe këtë fushë, qoftë duke mbikëqyrë Qeverinë ose duke shtuar mbikëqyrjen e Njesisë për Monitorimin e ndërmarrjeve publike, ndërsa në fund tha se Komisioni duhet ta ketë në fokus edhe këtë çështje.

Pal Lekaj, tha se do të angazhohet që puna e Komisionit të shkojë në favor të zhvillimit të gjithëmbarshtëm ekonomik, duke tejkaluar dallimet tona politike. Theksoi se në Planin e veprimit të Komisionit, sa përket i bordeve të agjencive, duhet të kemi një vëmendje më të shtuar, dhe duke marrë parasysh se me ligjet e agjencive të pavarura, kërkohet që bordet e agjencive të jenë të fushave të profesioneve të caktuar, e jo të kemi të emëruar politikë, siç ka ndodhur deri më tani.

Blerim Grainca, kërkoi që të gjendet një gjuhë e përbashkët në Komision, duke përjashtuar dallimet politike, në mënyrë që të arrijmë deri te një legjislacion i favorshëm, i cili do të ndikojë pozitivisht në

zhvillim ekonomik. Propozoi që Plani i veprimit të Komisionit do të ishte mirë që hartohet deri më 15 janar të vitit 2015, në mënyrë që të fillohet menjëherë me punën e Komisionit. Ai tha se agjencitë e pavarura kanë kontradikta të mëdha në funksionimin e tyre, prandaj duhet që të bëhet një ligj i veçantë për rregullimi e këtyre agjencive. Kërkoj që të ketë një komunikim më të madh në mes Komisionit dhe Qeverisë.

Sala Berisha-Shala, tha se Komisioni edhe në legjislaturën e kaluar ka pasur një funksionim shumë të mirë, përkundër dallimeve politike dhe diferencës së ngushtë pozitive - opozitive. Për të arriturat e punës së Komisionit, tha se është meritë edhe stafi mbështetës i Komisionit. Po ashtu, falënderoi edhe organizatën INDEP që ka mbështetur punën e Komisionit. Thëksoi se Komisioni ka një fushëveprim të gjerë, sepse kemi nën mbikëqyrje tri ministri dhe shtatë agjenci dhe kërkoj nga anëtarët e Komisionit që të jenë aktivë dhe të bashkëpunojnë në përmbushjen e detyrimeve dhe obligimeve që ka Komisioni. Lidhur me agjencitë, tha se këto janë formuar me ligje veç e veç, prandaj dhe dallojnë në fushëveprimin e tyre dhe janë mjaft komplekse dhe ka qenë pikë e dobët edhe në mandatin e kaluar. Ajo kërkoj që kryetari i Komisionit të angazhohet për të gjetur mënyra të bashkëpunimit edhe me komisionet e ngjashme të vendeve tjera, sepse ky Komision padrejtësisht nuk e ka të zhvilluar këtë aspekt, diçka që është shumë e rëndësishme në funksionim të Komisionit, sepse i shohim edhe praktikatat e vendeve tjera sesi funksionojnë.

Besim Beqaj, në fillim shprehu kënaqësinë që është pjesë e këtij Komisioni të rëndësishëm, duke premtuar angazhim maksimal në kryerje të obligimeve që dalin në të ardhmen. Ai tha se duhet të dallohen raportet e legjislativit, pra Kuvendit me atë të ekzekutivit - Qeverisë, sa i përket agjencive të pavarura dhe ndërmarrjeve publike, sepse agjencitë e pavarura i raportojnë Kuvendit, ndërsa ndërmarrjet publike Qeverisë. Fushëveprimi primar i Komisionit është shqyrtimi i ligjeve dhe monitorimi i tyre në Qeveri, pra sa po zbatohen. Ai shtoi se agjencitë e pavarura që janë të themeluara nga Kuvendi me ligje, dhe dizajnimi i tyre, secila në formën e vet të veçantë, duhet të trajtohet tema së pari se a kemi nevojë për të gjitha këto agjenci, ndërsa bordet që propozohen dhe kalojnë përmes Qeverisë, mandej Kuvendi i emëron ato, ndërsa ne si Komision duhet të ndikojmë që të bëhet një seleksionim i tyre sa më i mirë, që të kemi borde profesioniste, në pajtim me ligjet.

Sasha Milosavljeviq, tha se na pret një punë e madhe dhe do të kemi sfida, prandaj duhet që të bëjmë një punë ekipore, që të arrijmë rezultate për të mirën vendit dhe t'i zgjidhim problemet e përditshme të qytetarëve, duke tejkaluar dallimet politike. Po ashtu, falënderoi stafin mbështetës të Komisionit për përgatitjen dhe organizimin e mirë të mbledhjes së Komisionit, sepse kur kemi një staf të mirë, do të mund të bëjmë edhe ne si deputetë punë të mirë.

Raif Qela, tha se kemi shumë detyra para vetes dhe puna jonë do të na vlerësohet, nëse përkushtohemi të gjithë në përmbushjen e planit të punës. Ai potencoi çështjen e Projektligjit për Trepçën dhe tha se, pasi që në mandatin e kaluar, edhe pse ka kaluar në lexim të parë, me shpërbërjen e Kuvendit ai është kthyer përsëri në Qeveri, ndërsa tani duhet të kërkojmë që ai projektligj të riprocedohet sa më shpejt, sepse ka kërkesa të shumë kreditorëve, të cilët padrejtësisht po kërkojnë që të marrin përfitime nga TREPÇA, mirëpo nëse ne e nxjerrim një ligj në favor të zhvillimit të kësaj ndërmarrje, atëherë përgjigjja do t'u jepet atyre më së miri me anë të ligjit.

Visar Ymeri, tha se sa i përket ndërmarrjeve publike, ne si Komision mund të shtojmë monitorimin e tyre, sepse është Njësia në kuadër të Ministrisë për Zhvillim Ekonomik dhe duhet të jemi më të angazhuar në këtë drejtim, sepse më herët ne kemi pranuar vetëm një raport nga Qeveria dhe atë me vonesë, por më asnjëherë nuk jemi marrë me atë çështje.

Besim Beqaj, tha se ne si Kuvend dhe si Komision, këtë çështje, jo vetëm të ndërmarrjeve publike, por edhe të agjencive, mund ta rregullojmë vetëm përmes ligjit dhe jo në forma tjera. Mund ta rishikojmë legjislacionin dhe mandej do të kemi një situatë tjetër.

Kryetari, pas deklaramit të deputetëve, tha se është optimist se do të punojmë së bashku që t'u dalim përballë sfidave që na presin në të ardhmen. Ndërsa, sqaroi se Plani i punës do të hartohet

kur të kemi Strategjinë Legjislative të Qeverisë, mirëpo nuk na pengon asgjë që të kemi një skicë të përgatitur nga shërbimi i Komisionit se çfarë ka punuar më herët ky Komision dhe cilat çështje kanë mbetur në gjysmë. Po ashtu, do të kërkojmë edhe nga partnerët që të na ndihmojnë me ekspertiza të tyre, sepse kemi një staf minimal në Komision dhe një buxhet po ashtu minimal.

Pas debatit, Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

- 1. Stafi i Komisionit të përgatitë një raport lidhur me aktivitetet e deritanishme të Komisionit dhe përgjegjësitë që ka nën mbikëqyrje;*
- 2. Stafi i Komisionit të përgatitë një skicë të Planit të punës së Komisionit dhe t'ia dorëzojë Komisionit, para datës 15 janar 2015;*
- 3. Mbledhjet e Komisionit, në parim, të mbahen ditëve të marta, prej orës 11:00.*

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa